



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 86-të të mbajtur më 05.05.2023, miratoi sa vijon.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-935/1 të datës 11.02.2020, me pretendime për parregullsi në procedurën e falimentimit ndaj /// ///, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprime kompetente për rastin e lëndës.

Lënda me numër 12-935/1 të datës 11.02.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi të publikohet në formë të depersonalizuar në ven faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 11.02.2020 është paraqitur denoncim me pretendime për parregullsi në procedurën e falimentimit ndaj /// /// dhe është formuar lënda me numër 12-935/1 të datës 11.02.2020.

Në kërkesën, e cila nuk tregon ndonjë veprim korruptiv dhe që nuk tregon persona dhe ngjarje të veçanta që tregojnë për veprime korruptive, parashtruesi pretendon disa parregullsi në procedurën e falimentimit kundër /// ///, konkretisht: mos thirrja e Asambleja e kreditorëve dhe punonjësve të falimentimit me qëllim të pranimit të llogarisë përfundimtare dhe raporteve përfundimtare pas propozimit të paraqitur dhe emergjencave; fshirja e shoqërisë /// /// nga regjistri i shoqërive tregtare, fshirja e të drejtës shfrytëzuese në IL /// dhe IL /// dhe fshirja e pronësisë së aksioneve të regjistruara në CDHV pa një vendim përfundimtar për të përfunduar procedurën e falimentimit; referencë për të njëjtin vendim të kundërligjshëm me rastin e paraqitjes së kërkesës për privatizimin e tokës ndërtimore të regjistruar në IL /// KK ///.

Në denoncim, i cili i është drejtuar Prokurorisë Themelore Publike ///, dhe në të cilin thuhet se i është dorëzuar Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Drejtësisë, parashtruesi i denoncimit shpreh dyshimin se parregullsitë e cekura u shkaktuan dëm punonjësve të falimentimit dhe aksionarëve të /// ///, dhe kërkon që të gjitha vendimet e paligjshme në procedurën e falimentimit të kontrollohen dhe anulohen.

Pas shqyrtimit tē pretendimeve nē fjalē, KSHPK konstatoi se pretendimet e raportuara nuk janē korrupsion sipas pērkufizimit tē pērcaktuar nē Ligjin pēr Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit tē Interesit dhe nuk i nēnshtrohen veprimeve tē saj kompetente, pas sē cilēs ka konstatuar se nuk ka elemente pēr veprim kompetent pēr rastin nē fjalē .

Duke pasur parasysh sa mē sipēr, KSHPK vendosi si nē dispozitiv tē kētij vendimi.

Dorēzuar:

- parashtruesit tē denoncimit

Pērpiloi: A.R.M.

mīratoi: G.T., anētar i KSHPK-sē

**KOMISIONI SHTETЌOR
PЉR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Kryetar
Biljana Ivanovska

